



QENDRA E TRAJNIMEVE &  
BURIMEVE PËR AVOKIM

# AVOKUESI

## Përkrahë Organizatat Jo-qeveritare

Vëllimi VI • Numri 2 • Gusht 2008

### Fuqizohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës

#### PËRMBAJTJA

##### Faqe 2

Debate me qytetarë, "Pyjet Janë Pasuri Kombëtare, t'i Mbrojmë Ato"

Programi i Trajnimeve, Zgjerohet Efikasiteti i Trajnimeve për Zgjidhjen e Konfliktit Shumëpalësh

Konsulenca dhe Trajnime të Përkrahura nga UNDP

##### Faqe 3

Ngjarje Ndërkombëtare, EUCLID - Takimi Evropian i Liderëve të Sektorit të Tretë

Biblioteka e ATRC - së me Koleksione të Rëndësishme për Lexuesit

## Hyrja në Fuqi e Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Më 15 qershor 2008, organizuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në një ceremoni solemne u shënua fuqizimi i Kushtetutës së Kosovës, ku morën pjesë udhëheqësit më të lartë kosovarë, si dhe përfaqësues të shumtë të pranisë civile e ushtarake ndërkombëtare në Kosovë.

Në hapje të ceremonisë u ekzekutua Himni i Republikës së Kosovës. Kjo konsiderohet të jetë ceremonia e parë zyrtare e nivelit më të lartë, që u hap me ekzekutimin e Himnit Shtetëror të Republikës së Kosovës.

Pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, institucionet e ven-

dit presin të marrin mbivete përgjegjësitë që deritash i ushtronte administrata e Kombeve të Bashkuara që pritet të riorganizohet në pajtim me zhvillimet politike në Kosovë.

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC), duke qenë pjesë e procesit të bërjes së Kushtetutës, në bashkëpunim të ngushtë me Sekretariatit e Komisionit Kushtetues, ka qenë organizator i 42 debateve publike me qytetarë të komunave të Kosovës.



Për më shumë informata, vizitoni:  
[www.kushtetutakosoves.info](http://www.kushtetutakosoves.info)

## ATRC Shënon Shtatë-Vjetorin e Punës së Suksesshme

Përmes një ceremonie rasti, me date 16 qershor 2008, Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC, shënoi shtatë-vjetorin e punës së saj, e vlerësuar me tre drejte e periudhe të sukseseve dhe njëherësh edhe një fillim i ri në përkrahje të aktiviteteve të shoqërisë civile, pas pavarësisë së Kosovës.

Ne këtë takim morën pjesë; përfaqësues të shumtë të institucioneve lokale dhe nacionale, donatorë të ndryshëm, përfaqësi diplomatike, OJQ-të partnere të ATRC-se, etj.

Donatorë dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme, premtuan se përkrahja dhe bashkëpunimi i deritashëm me ATRC-ne do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Të pranishmit në këtë ceremoni vizituan edhe objektin e ri të ATRC-së.

Për informata, më të hollësishme kontaktoni: [info@advocacy-center.org](mailto:info@advocacy-center.org)

Rr. Gazmend Zajmi Nr. 20  
Prishtinë, Kosovë. Telefon/Fax:  
+381 (0) 38 244 810

## Debate me Qytetarë

## Konsulenca dhe Trajnime të Përkrahura nga UNDP

Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara - UNDP / Roma Regional, në kuadër të fondit për përkrahjen e projekteve të Organizatave Joqeveritare për komunitetin RAE, gjatë muajit qershor përzgjodhi ATRC-në për mbajtjen e trajnimeve me temat: "Lidershipi dhe Menaxhimi" si dhe "Orientimi me klientë". Këto trajnime, të dedikuara për zyrtarët e Ministrisë së Kthimit dhe Komuniteteve, synuan ngritjen e kapaciteteve në fushën e zhvillimit organizativ për zyrtarët e kësaj ministrie.

Ekipi i Trajnimeve i ATRC-së gjithashtu u angazhua në ofrimin e një serie konsulentash, për organizatat joqeveritare të komunitetit RAE të komunës së Ferizajt dhe të Prizrenit.

Përmes procesit të ashtuquajtur "Mëso duke bërë", stafi i ATRC-së kompletoi rreth 20 projekt propozime të hartuara nga Organizatat e komunitetit RAE të komunës së Ferizajt dhe Prizrenit.

ATRC gjithashtu me përkrahje nga UNDP-UNV, mbajti edhe trajnime për "Ndërtim të koalicionëve" me përfaqësuesit e OJQ-ve lokale. Me këtë rast gjatë muajit qershor u mbajtën 5 trajnime në 5 regjione të Kosovës, si në: Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan. Trajnimet u organizuan me qëllim të lehtësimit të procesit të krijimit të koalicionëve për "Punën vullnetare" si dhe u bazuan nga iniciativat dhe nevojat e OJQ-ve lokale nga këto regjione.

Për më shumë informata, kontakti: [training@advocacy-center.org](mailto:training@advocacy-center.org)

## Pyjet Janë Pasuri Kombëtare, t'i Mbrojmë Ato

Me qëllim të sensibilizimit të opinionit për mbrojtjen e pyjeve dhe tokave pyjore të Kosovës, ATRC në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Departamenti i Pylltarisë, gjatë muajit maj dhe qershor, organizuan një varg ligjëratash dhe debatesh me banorë të fshatrave të Kamenicës, Istogut dhe Suharekës si dhe më nxënës të shkollave fillore të po këtyre fshatrave.

Ndërprerja dhe parandalimi i dëmtimit të pyjeve, vetëdijesimi i banorëve për mbrojtjen e tyre, ishin tema diskutimi në ligjëratat dhe debatet e organizuar. Zyrtarët e Ministrisë së Bujqësisë, përkatësisht të De-

partamentit të Pylltarisë, në të gjitha takimet vlerësuan se është interes i të gjithëve mbrojtja dhe kultivimi i pyjeve dhe se ato duhet t'i shikojmë dhe trajtojmë si pasuri kombëtare. Pyjet janë pasuri jetike dhe strategjike për jetën në toke dhe si të tilla ndikojnë drejtpërdrejt në ekosistemin në përgjithësi, florën dhe faunën në veçanti theksuan zyrtarët e pranishëm.

Nxënësit dhe banorët e fshatrave, përmes diskutimeve dhe komenteve të tyre paraqitën interesimet dhe shqetësimet e tyre për gjendjen e pyjeve të Kosovës dhe veçanërisht dëmtimin sistematik të tyre. Ata potencuan se menaxhimi i py-

jeve në Kosovë nuk është i mirë për shkak të mungesës së bashkëpunimit ndërinstitucional.

Është koha e fundit që të gjithë mekanizmat institucionale, përfshirë këtu edhe shoqërinë civile dhe mediat, t'i bashkërendisin aktivitetet e tyre në drejtim të shpëtimit të sipërfaqes së mbetur me pyje pasi trendi në rritje i shkatërrimit të pyjeve nga prerësit dhe transportuesit ilegalë të druve rrezikon me shkatërrimin e tërësishëm të sipërfaqes pyjore që ka Kosova.

Për më shumë informata, kontakti: [info@advocacy-center.org](mailto:info@advocacy-center.org)



## Programi i Trajnimeve

## Zgjerohet Efikasiteti i Trajnimeve për Zgjidhjen e Konfliktit Shumëpalësh

Rritja e nivelit të njohurive të shërbyesëve civilë dhe atyre të shoqërisë civile për menaxhim të konfliktit ishte qëllimi i trajnimeve të organizuara në temën: "Menaxhimi i Konfliktit" të mbajtura nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC, në kuadër të projektit "Zgjidhja e konfliktit shumëpalësh" të financuar nga Olof Palme

Center.

Pjesëmarrësit përmes prezantime të ndryshme dhe diskutime në grupe, ndanë përvoja të ndryshme të menaxhimit të konfliktit në vendet ku ata punojnë.

Gjatë procesit të trajnimit u punua me tema të karakterit teorik-praktik si: Kuptimi i konfliktit, Puna me konfliktin, Konfliktet shoqërore,

Ndryshimet dhe demokracia, Rolet, Komunikimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, etj.

Shyhyrete Reçica nga Lipjani, pjesëmarrëse në këtë trajnim në fund të trajnimit vlerësoi atë si: "Ky trajnim është mjaft i qëlluar pasi që gjatë procesit trajnues, ..."

**Vazhdon në faqen tjetër...**

## Programi i Trajnimeve

## Zgjerohet Efikasiteti i Trajnimeve për Zgjidhjen e Konfliktit Shumëpalësh

## Vazhdon nga faqja 2

..... përkatësisht gjatë ushtrimeve të ndryshme, kemi mundësinë edhe t'i identifikojmë problemet tona konfliktuoze, me të cilat kushtimisht ballafaqohemi në përditshmëri në vendet tona ku punojmë. Janë një mësim i mirë për të ditur se si të sillemi me situata të ndryshme

konflikti". Trajnimi gjithashtu solli një mundësi për pjesëmarrësit e komunave të ndryshme, të bëjnë rrjetëzim me homologët e tyre nga komunat të tjera, të shkëmbejnë ide, përvoja etj. Mbështetur nga Olof Palme International Center, ky projekt, i cili ka filluar nga janari i këtij viti, do të implementohet në 15 komuna të Koso-

vës, përfitues të së cilës do të jenë kryesisht pjesëtarët e shoqërisë civile, shërbyesit civilë dhe komuniteti në përgjithësi. Deri më tash janë mbajtur 10 trajnime ndërsa projekti do të vazhdojë deri në fund të dhjetorit 2008.

**Ushtrues Detyre i Drejtorit Ekzekutiv**  
KUSHTRIM KALOSHI  
kushtrim@advocacy-center.org

**Menaxher i Financave & Administratës**  
GANI ASLLANI  
gani@advocacy-center.org

**Menaxhere e Shërbimeve të Trajnimeve & Konsulentëve**  
DONIKA SALIHU  
donika@advocacy-center.org

**Trainere & Konsultante**  
AFERDITA SURROI  
aferdita@advocacy-center.org

**Trainere & Konsultante**  
NORA SUSURI  
nora@advocacy-center.org

**Komunikim & Punë me Jashtë**  
SHUKRIJE RAMA  
shukrije@advocacy-center.org

**Menaxher për TI & Databazë**  
ARSIM KOSUMI  
arsim@advocacy-center.org

## Ngjarje Ndërkombëtare

## EUCLID - Takimi Evropian i Liderëve të Sektorit të Tretë

Organizuar nga Rrjeti EUCLID, gjatë muajit qershor 2008, në Bruksel, u mbajt takimi vjetor me 100 liderë të sektorit të tretë të Evropës. Rreze Duli, ish-drejtoreshë e ATRC-së, e ftuar nga organizatorët e EUCLID NETWORK, vlerësoi se qëllimi i këtij takimi në nivel ndërkombëtar ishte nxitja e bashkëpunimit më të mirë ndërmjet institucioneve evropiane dhe shoqërisë civile, për një Evropë të bashkuar, duke ofruar rrjetëzim dhe praktikë të mirë ndërmjet 100 liderëve të sektorit të tretë, dhe zyrtar-



rëve të Këshillit Evropian. Sipas saj, qëllimi i EUCLID NETWORK është të zhvillojë, të bashkojë si dhe të përkrahë liderët e Shoqërisë Civile në Evropë, me qëllim që ta bëjë këtë sektor sa më profesional. Me kumtesat e tyre, në këtë takim u paraqitën përfaqësues të Parlamentit Evropian

si dhe të institucioneve të tjera evropiane: si Patrizia Toia, John Bouis etj, Pat Samuel, Jean-Marc Roirant, etj. U lexuan edhe kumtesa tjera me interes për këtë takim. Pas përfundimit të prezantimeve, të pranishmit vizituan Parlamentin Evropian ku u pritën nga anëtarët e Parlamentit Evropian, përkatësisht nga Grupi Parlamentar për Ekonomi Sociale.

Për informata shtesë vizitoni <http://www.euclidnetwork.eu>

## Biblioteka e ATRC - së me Koleksione të Rëndësishme për Lexuesit

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC, është e përkushtuar edhe në përhapjen e informatave përmes publikimeve, mbledhjes dhe dhënies në huazim të hulumtimeve të ndryshme, shpërndarjen e burimeve informative me institucionet tjera me interes të përbashkët, etj. Aktualisht, ATRC po pasuron Bibliotekën e saj me tituj dhe botime të reja, marre këto nga Organizata dhe partnere lokal. Biblioteka e ATRC-se tashmë ka rreth 1000 tituj libra, gazeta, revista, raporte, studime etj. Botimet janë kryesisht në gjuhën angleze, shqipe, serbe, gjermane etj. E ve-

çantë e kësaj biblioteke është se ajo përmban koleksione interesante të studimeve, raporteve, dhe udhëzuesve për çështje politike, ekonomike, dhe sociale në Kosovë të publikuara nga organizata vendore dhe ndërkombëtare. Shumica e publikimeve janë të botuara kryesisht në vitin 2000 e këndeje. Mbledhja e koleksioneve është fryt i bashkëpunimit me institucione tona qeveritare dhe joqeveritare, si KIPRED, RIINVEST, UNDP, UNHCR, Qendra për të Drejtat e Njeriut e UP-së, Fondi për të Drejtën Humanitare, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të

Njeriut, Qendra për Arsim e Kosovës, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, REC, UNICEF, e shumë organizata tjera. Biblioteka e ATRC-se, do të vazhdojë veprimtarinë e saj edhe në të ardhmen, ndërsa është e gatshme t'u ofrojë shërbimeve efikase organizatave lokale dhe ndërkombëtare, studentëve të Universitetit të Prishtinës, gazetarëve, punëtorëve qeveritarë, si dhe çdo qytetari të interesuar.

For more information, contact: [info@advocacy-center.org](mailto:info@advocacy-center.org)